



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	10.05	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK	4471/2023		118	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.573/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.573/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilën me autorizim e përfaqëson me adresë:

kundër Vendimit me Nr.152/2023 të datës 22.03.2022 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.573/2023 e datës 27.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.152/2023 i datës 22.03.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil me datë 27.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3017/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.152/2023 të datës 22.03.2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimet për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit me datë 03.04.2023 e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 14.04.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për qasje në dokumente publike e datës 19.12.2022; E-mailin e datës 27.03.2023 dërguar nga ankuesi për Raportin e datës 14.04.2022 të Komisionit të Ristrukturim i MPJD-së; Shtojcën: I-Formula e Vlerësimit për pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme; Vendimin Nr.152/2023 të datës 22.03.2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin e Këshillit A.nr.1041/2022 të datës 20.01.2023; E-mailin e datës 01.03.2023 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore të MPJD-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.04.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 14.04.2023; Raportin e veçantë të datës 07.03.2023 i Komisionit të Ristrukturimit të MPJD-së; E-mailin e datës 07.03.2023 dërguar nga ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur; E-mailin e datës 19.03.2023 dërguar nga B.B për ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur prej 5 faqesh; E-mailin e datës 10.03.2023 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 02.03.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore të MPJD-së për ankuesin; E-mailin e datës 03.03.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore të MPJD-së për ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 28.02.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore të MPJD-së për ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 27.02.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore të MPJD-së për ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 23.02.2023 dërguar nga Burimet Njerëzore të MPJD-së për ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 03.03.2023 dërguar nga ankuesi për Burimet Njerëzore të MPJD-së me korrespondencën e bashkëngjitur prej 3 faqesh; Ankesën me numër protokoli 7312/2022 të datës 22.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 144/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; E-mailin e datës 31.10.2022 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore me korrespondencën e bashkëngjitur prej 6 faqesh; Shkresën e datës 30.09.2010; Shkresën e datës 01.08.2022 me numër reference: 10/2022 me numër prot:2955; Çertifikatën e datës 05.06.2009; Çertifikatën e datës 22.12.2009; Çertifikatën e datës 23.06.2010; Çertifikatën e datës 11.02.2016; Çertifikatën e datës 01.12.2010; Çertifikatën e datës 16.02.2016; Çertifikatën e datës 08.02.2012; Çertifikatën e muajit dhjetor 2008; Diplomën e datës 10.11.2021 me numër:127/21; Diplomën e datës 08.02.2006 me numër:1385; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit; Kërkesën e datës 20.04.2021 me referencë:AKK-02-03-948/21; Reagimin e datës 24.08.2022 me referencë:11/2022; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit" e datës 31.05.2022; Kërkesën e datës 31.05.2022 me numër prot:1917; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit" e datës 01.08.2022; Vendimin e datës 19.05.2017; Kërkesë e datës 28.07.2022; Shkresën e titulluar "letër-pajtueshmëri për dhënien e nënshkrimit" e datës 17.05.2022; Ankesën e datës 17.05.2022 me referencë:07/2022; Kërkesën për inspektim të datës 10.05.2022; E-mailin e datës 05.04.2022 dërguar nga A.H për B.G; Kërkesën e datës 11.03.2022; Kërkesën e datës 27.09.2022 dërguar për DMZP; Ë emërimin e ankuesit të datës 05.09.2012; Çertifikatën e datës 17.06.2022; Vendimin e datës 21.08.2019 i Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 15.09.2022 me numër:138/2022 të Departamentit për Menaxhimin e

Zyrtarëve Publik; Ë emërimin e datës 08.04.2021 me shifër Nr.27/2021; Referencën e datës 10.08.2004; Vendimin e datës 05.01.2004; Kontratën e punës e datës 01.01.2004; Letër referencën e datës 10.12.2007; Kontratën e punës të datës 09.05.2007; Kontratën e punës të datës 01.08.2010; Kontratën e punës e datës 01.08.2008; Vendimin për emërim i datës 28.07.2008 me numër:97/08; Vendimin për dhënien eës nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 30.04.2014; Vendimin e datës 13.07.2018; Vendimin e datës 04.03.2014 i Komisionin për Grada dhe Disiplinë; Vendimin me numër ref:35/2016 (data e palexueshme), Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2017; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2016; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2015; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2013; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2011; Formulari i vlerësimeve të rezultateve në punë për vitin 2020; E-mailin e datës 21.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në kërkesë e datës 16.12.2022; Vendimin e datës 01.02.2022 me nr.214/2022 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; E-mailin e datës 28.10.2022 lidhur me pozitën e mbetura të lira dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 27.10.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës i datës 16.03.2022 i DMPZP-së; E-mailin e datës 12.10.2022 dërguar nga për Këshillin me korrespondencën e bashkangjitur; Listën e sindikatave të regjistruara; Përgjigjen e datës 13.12.2022; Vendimin për transferim i datës 15.09.2022; Raporti i veçantë i punës së Komisionit të Ristrukturimit i datës 31.10.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në MPJD; Konkursin e datës 18.01.2022; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Arkivës nder komunale në Prishtinë-Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin Rajonal dhe Koordinimin e Nismave Rajonale në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtorisë për Administratë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës; Shkresën-Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Akt emërimin e ankuesit të datës 08.04.2021 me numër AE.nr.27/2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 31.10.2022 dërguar nga ankuesi për Njësinë e Burimeve Njerëzore me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 27.10.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Shkresën-Shtojca I-Formula e vlerësimit, për pozitën-Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme; E-mailin e datës 07.10.2022 dërguar na për E-mailin e datës 12.12.2022; E-mailin e datës 12.12.2022 dërguar nga për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *pabazuar*, sepse:

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton së më Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht nëpunësit civil të institucionit se në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se në bazë të Ë Emërimit me shifër AE.Nr.77/2020 të datës 08.04.2021 ka qenë i punësuar në pozitën *Udhëheqës i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme* në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë, respektivisht është ndarë si departament dhe janë paraparë dy (2) pozita, si vijon: pozita *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa* si dhe pozita *Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme*.

Meqenëse pozita që ka mbajtur ankuesi ka pësuar ndryshime, ndërsa për pozitën *Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme* ankuesi nuk ka arritur të grumbulloi më shumë pikë sesa kandidati tjetër dhe i njëjti nuk ka arritur të emërohet sipas preferencës së tij, kurse sa i përket kualifikimeve të posaçme respektivisht njohjes së gjuhës së huaj, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka mund të emëroj ankuesin në një pozitë të kategorisë së njëjtë brenda Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pozita të cilat ishin të lira në kohën e transferimit fillestar, për arsye se i njëjti nuk ka plotësuar kriteret e veçanta formale për pozitat përkatëse, ndërsa nga Komisioni i Ristrukturimit përmes me numër protokoll:1620 të datës 01.11.2022 e ka rekomanduar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë transferimin në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ndërsa përmes Vendimit me Nr.144/2022 i datës 10.11.2022 i Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ankuesi është transferuar në pozitën *Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme* në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ankuesi më datë 22.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër A.nr.1041/2022 të datës 20.01.2023 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen e ankuesit me qëllim që të njëjtit t'i ofrojë ndonjë pozitë tjetër në kuadër të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës meqenëse ankuesi ishte konsistent pranë kërkesës që i njëjti të mbetet pjesë e shërbimit diplomatik, gjegjësisht të sistemohej në kuadër të MPJD-së qoftë në pozitën *Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme* sipas preferencës fillestare lidhur me ushtrimin e detyrave të punës që kishte sipas aktit të emërimit apo në ndonjë pozitë tjetër ekuivalente me të.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas vendimit të Këshillit me numër A.nr.1041/2022 të datës 20.01.2023, ka shqyrtuar çështjen e rastit të ankuesit dhe ka marr për bazë pikëpamjet juridike të Këshillit, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes e-mailit fillestar të datës 23.02.2023, propozim të cilin e kishte përsëritur edhe për tre herë tjera me datë 27.02.2023, 28.02.2023 dhe 02.03.2023 i kishte ofruar ankuesit propozimin për pesë (5) pozita profesionale që ishin të lira në kuadër të institucionit dhe për të cilat ankuesi i plotësohet kriteret e përgjithshme formale, mirëpo ankuesi një propozim të tillë

e kishte refuzuar përmes e-mailit të datës 01.03.2023 i plotësuar edhe përmes e-mailit të datës 03.03.2023. Tutje, pas refuzimit të ankuesit të pozitive profesionale të ofruara nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, atëherë Komisioni i Ristrukturimit përmes me numër protokollit:360 të datës 07.03.2023 e ka rekomanduar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë transferimin e ankuesit në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ndërsa përmes Vendimit me Nr.152/2023 i datës 22.03.2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ankuesi është transferuar në pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se me rastin e poentimit të kandidatit tjetër i cili është caktuar në pozitën e Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme se Komisioni i Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material me rastin e transferimit të nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit, Kolegji i Këshillit konstaton se një pretendim i tillë pavarësisht që është konsumuar ngase është shqyrtuar edhe në vendimmarrjet paraprake, sërish thekson faktin se ky pretendim është i paqëndrueshëm, ngase kundër kandidati tjetër i cili është nënshtruar formulës së njëjtë të poentimit sikurse ankuesi dhe se i njëjti ka arritur të grumbulloi gjithsejtë shtatëdhjetë e tetë (78) pikë apo për secilën fushë si vijon: (1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil-20 pikë, 2. Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë-24 pikë; 3. Kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë-20 pikë dhe 4. Trajnimet -8 pikë), ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë pesëdhjetë e tetë (58) pikë apo për secilën fushë si vijon: (1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil-18 pikë, 2. Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë-12 pikë; 3. Kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë-20 pikë dhe 4. Trajnimet -14 pikë), nga rrjedh se diferencën më të madhe prej 12 pikëve të vlerësimit ankuesi e ka në fushën e vlerësimit e rezultateve në punë, dhe se për këtë çështje ankuesi nuk ka mund të argumentojë me prova të kundërtën e saj, nga rrjedh se edhe sikurse ankuesi të ishte poentuar njëjtë me pikë në fushën e vjetërsisë në shërbimin civil dhe Trajtimeve, përsëri nuk do të grumbullonte pikë më shumë se kandidati tjetër, andaj nga se u tha si më lartë pretendimi i ankuesit është i pabazuar ndërsa Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 14 paragraf 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sikurse përcaktohet: *"Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet"*.

Kolegji i Këshillit, fillimisht ka shqyrtuar pozitat e kategorisë së mesme drejtuese që kanë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në kohën kur ankuesi nuk kishte arritur të grumbulloi pikë më shumë sesa kandidati tjetër për pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, ndërsa kriteret për pozitat të cilat ishin të lira janë si në vijim: *Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate; Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike, Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë, Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare dhe Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit*, dhe ka konstatuar që për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze"*, për pozitën Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose*

ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”, për pozitën Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e gjuhës angleze ose gjuhën frënge e në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose gjuhën frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose gjuhën frënge”, për pozitën Drejtor i Departamentit për Organizatat Ndërkombëtare tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e ndonjë prej (6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura”, dhe për pozitën Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit, tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura”.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e hartimit të raportit të veçantë me numër protokoll:360 të datës 07.03.2023 përmes të cilit e rekomanduar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ta transferojë ankuesin në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ka gjetur se ka bërë përshkrimin e të gjithave të lira prej tyre katër (4) pozita të Drejtorëve, ndërsa gjashtëmbëdhjetë (15) pozita të Udhëheqësve të Divizioneve dhe prej të gjitha prej tyre kërkohen edhe kushte të veçanta formale, gjegjësisht për të njëjtat varësisht prej funksionit dhe detyrave që hyjnë në mandatin e tyre kërkohen njohje e gjuhëve të huaja, sikurse gjuha angleze, frënge, apo gjermane dhe atë duke filluar nga niveli C1-C1 e deri tek B2-C2 të dëshmuara me certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura, ndërsa sipas shkresave të lëndës respektivisht të dosjes së ankuesit të dërguara nga institucioni punëdhënës dhe provave të sjella nga ankuesi, Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk ofron një dëshmi të tillë se i njëjti njeh ndonjërin nga gjuhët e huaja të kërkuara për pozitën në fjalë, gjegjësisht nuk ka ndonjë certifikatë të lëshuar nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuara dhe i njëjti nuk mund të transferohet në asnjërin nga këto pozita që kanë qenë të lira, pasi që edhe dispozitat ligjore lidhur me transferimin për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit përcaktojnë kërkesat e veçanta formale sikurse në nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: “3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit”.

Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 22.11.2022 të cilën e kishte kthyer në ri-shqyrtim përmes vendimit A.nr.1041/2022 të datës 20.01.2023, ka pasur parasysh statutin e nëpunësit të shërbimit të jashtëm dhe ka dashur t'i ofrojë një mundësi ankuesit pasi që i njëjti insiston të mbetet pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në frymën e nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, mirëpo i njëjti duhet ta ketë parasysh faktin se dispozitat e ligjit të veçantë për shërbimin e jashtëm diplomatik nuk e përcaktojnë dhe as nuk e rregullojnë çështjen e transferimit të nëpunësit civil me rastin e ristrukturimit të institucionit sikurse në rastin konkret, prandaj mbi këtë bazë vlejné dispozitat e nenit 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114

për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil" dhe se transferimi i ankuesit në rastin konkret është bërë në pajtueshmëri me më normën e lartcekur, ndërsa ankuesi duhet ta ketë parasysht faktin e përcaktuar sipas nenit 15 paragrafi 4 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: "Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç atyre të përcaktuara me Neni 52. paragrafin 3 të Ligjit përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil" dhe se i njëjti nuk mund ta refuzojë transferin pasi që rastin konkret nuk plotësohen këto parakushte që ndërlidhen me nenin 52 paragrafit 3 të ligjit material sikurse janë gjendja shëndetësore, dhe distanca ndërmjet vendbanimi i nëpunësit civil me vendin ku transferohet.

Nga të cekurat si më lartë është konstatuar se pozita e ankuesit që ka mbajtur brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka pasur ndryshime në emërtim po ashtu edhe në kriteret respektivisht kualifikimet e posaçme, atëherë në këtë rast Kolegji i Këshillit ju referuar nenit 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: "Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës", ndërsa, pas ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Komisioni i Ristrukturimit ka bërë përpjekjet ligjore që ankuesi të sistemohet brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, por meqë i njëjti fillimisht kishte arritur të grumbulloi pikë më pak sesa kandidati tjetër për pozitën Drejtor i Departamenti të Shërbimeve të Përgjithshme, ndërsa për pozitën e tjera të lira të kategorisë së njëjtë nuk ka plotësuar kriteret e veçanta formale, atëherë mundësia e vetme ka qenë propozimi për transferim në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ashtu siç parashihet edhe me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil". Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e përgatitjes së raportit veçantë me numër protokolli 360 të datës 07.03.2023 me propozimin për transferimin e ankuesit pas shterjes së mundësive duke respektuar pikëpamjet juridike të vendimit të Këshillit A.nr.1041/2022 të datës 20.01.2023, ka vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-tekniqë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë" në

mbështetje edhe te nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ndërlidhur me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstatoi se transferimi i ankuesit me rastin e ristrukturimit të institucionit është zbatuar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, prandaj mbi këtë bazë Vendimi Nr.152/2023 i datës 22.03.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik mbeten në fuqi pasi që ankuesi i plotëson kriteret e parapara për pozitën në të cilën është transferuar ndërsa ankesa e ankuesit e datës 27.03.2023 është e pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.573/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së